



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SH.A.
DEPARTAMENTI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë , më ____/____/2018

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: “**rami-company** ” sh.p.k

1.1 Procedura e prokurimit: “E HAPUR”

1.2 Numri i referencës së procedurës/lotit : REF -69596-05-17-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: ” **Blerje elektropompa për nevoja të Shoqërisë**” me fond limit **11.600.000 (njëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind mijë) lekë pa TVSH,**
Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike ,

1.3 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “Buna” sh.p.k

J61826501C

Vlera 0(zero)

2. “Mazreku -2014”sh.p.k

L52317046G

Vlera 8.415.465(tetë milion e katërqind e pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë)lekë pa tvsh.

3.“ Vibtis ”sh.p.k

L02103503S

Vlera 8.898.999,52(tetë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë presje pesëdhjetë e dy)lekë pa tvsh.

4. Rami-Company sh.p.k

L61327009F

Vlera 9.610.000(nëntë milion e gjashtëqind e dhjetë mijë)lekë pa tvsh

5. **e-pumps** sh.p.k

L71420020I

Vlera 11.055.000(njëmbëdhjetë milion e pesëdhjetë e pesë mijë)lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm

1. “ Buna” sh.p.k

J61826501C

Vlera 0(zero)

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “BUNA” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën e DT.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “BUNA Sh.p.k s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 8, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. “Mazreku -2014”sh.p.k

L52317046G

Vlera 8.415.465(tetë milion e katërqind e pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë)lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 2.8 si dhe në shtojcën për modifikim të pasqyruar në sistemin elektronik datë 05.06.2018 si më poshtë cituar:

2.8.Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë origjine të mallit që oferton.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin elektronik operatori ekonomik ka paraqitur autorizim prodhuesi lëshuar nga kompania WILO për të cilët ka bashkëngjitur 1 deklaratë në të

cilën në përmbajtje të saj shprehet se :**Ne WILO deklarojmë se certifikata e origjinës nuk mund të lëshohet më përpara se pompat nuk janë lëvruar klientit.**

Referuar dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik sqarojmë se lëshimi i deklaratës se certifikata e origjinës do të lëshohet në momentin e lëvrimin të mallit nuk përbën përmbushje të kriterit të kërkuar në DST.

K.V.O gjen vend të theksojë se mospërmbushja e kriterit të kërkuar në pikën 2.8 të DST bie në kundërshtim edhe me rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik prot 3341/1 datë 20.03.2018 në të cilën parashikohet se certifikatat duhet të dorëzohen elektronikisht në sistemin elektronik.

Referuar frymës së legjislacionit të prokurimit publik në fuqi gjykojmë se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi dhe është detyrë e operatorëve ekonomikë të dorëzojnë ofertën në përputhje me dokumentet e tenderit dhe kërkesat e autoritetit kontraktor.

Në këtë kuptim, referuar dispozitave ligjore Neni 46 pika b të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku citohet se **Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme që AK i vlerëson të nevojshme.....**

Në këtë rast K.V.O është e detyruar të zbatojë nenin 55 /2 të ligjit nr.9643,datë 20.11.2006”Për prokurimin Publik” i ndryshuar në të cilën citohet se ...Autoriteti Kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme për të përcaktuar ofertën fituese ne perputhje me procedurat dhe kriteret e percaktuara ne dokumentat e tenderit.

Pra, K.V.O gjykon se duhet të vlerësojë përmbushjen e çdo kriteri për kualifikim që gjendet në DT dhe operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatitin ofertat dhe të paraqesin të plotë dokumentacionin e kërkuar në DT.

Referuar seksionit II të dokumentave të tenderit “Udhëzime për operatorët ekonomikë” “Hartimi I Ofertës”ku përcaktohet se: “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme

Po kështu sqarojmë se nëse operatori ekonomik do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, apo paqartësi ai ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës parashikuar në nenin 63 pika 1/1 e LPP apo nenin 42/1 për të kërkuar shpjegime pranë AK .

Së dyti A.K ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.5.Prodhuesi i mallit duhet të jetë i certifikuar për sistemin e menaxhimit të cilësisë me certifikatë ISO 9001:2008(Ose ekuivalent)për prodhimin e mallrave objekt prokurimi lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Certifikatat kërkohet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të

tenderit.

2.6.Prodhuesi i mallit duhet të jetë i çertifikuar për sistemin e menaxhimit të mjedisit çertifikatë ISO 14001:2004 lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Certifikatat kërkohej të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të kërkuar operatori ekonomik ka paraqitur në sistemin elektronik çertifikatë ISO 9001:2008 si dhe çertifikatë ISO 14001:2004 të kompanisë prodhuese WILO.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur K.V.O vëren se çertifikatat e paraqitura janë në gjuhën angleze.

K.V.O gjen vend të citojsë se operatori ekonomik për përgatitjen e dokumentacionit duhej ti përmbahej shtojcës 9 të kriterëve të përgjithshme për të cilën citohet se... **Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.**

Po kështu në nenin 14 të VKM nr,914 datë 29.12.2014”Për Prokurimin Publik”I ndryshuar parashikohet shprehimisht: “Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe”. **Në dokumentat e tenderit, Seksioni IV Procedura, pika IV.6 është përcaktuar shprehimisht: “Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Shqip X Anglisht Tjetër.**

Përsa më sipër dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik MAZREKU-2014 do të konsiderohet I pasaktë e për rrjedhojë i pavlefshëm.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII,Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3.“ Vibtis ”sh.p.k

L02103503S

Vlera 8.898.999,52(tetë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë presje pesëdhjetë e dy)lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 2.8 si dhe në shtojcën për modifikim të pasqyruar në sistemin elektronik datë 05.06.2018 si më poshtë cituar:

2.8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë origjine të mallit që oferton.
2.8.Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë origjine të kompanisë prodhuese të mallit që oferton.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin elektronik operatori ekonomik ka paraqitur autorizim prodhuesi lëshuar nga kompania eILO për të cilët ka bashkëngjitur 1 deklaratë në të cilën në përmbajtje të saj shprehet se :**Ne WILO sh.p.k deklarojmë se çertifikata e origjinës nuk mund të lëshohet më përpara se pompat nuk janë lëvruar klientit.**

Referuar dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik sqarojmë se lëshimi i deklaratës se çertifikata e origjinës do të lëshohet në momentin e lëvrimit të mallit nuk përbën përmbushje të kriterit të kërkuar në DST.

K.V.O gjen vend të theksojë se mospërmbushja e kriterit të kërkuar në pikën 2.8 të DST bie në kundërshtim edhe me rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik prot 3341/1 datë 20.03.2018 në të cilën parashikohet se çertifikatat duhet të dorëzohen elektronikisht në sistemin elektronik.

Referuar frymës së legjislacionit të prokurimit publik në fuqi gjykojmë se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi dhe është detyrë e operatorëve ekonomikë të dorëzojnë ofertën në përputhje me dokumentet e tenderit dhe kërkesat e autoritetit kontraktor.

Në këtë kuptim, referuar dispozitave ligjore Neni 46 pika b të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku citohet se **Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....**

Në këtë rast K.V.O është e detyruar të zbatojë nenin 55/2 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006”Për prokurimin Publik” i ndryshuar në të cilën citohet se ...Autoriteti Kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme për të përcaktuar ofertën fituese në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Pra, K.V.O gjykon se duhet të vlerësojë përmbushjen e çdo kriteri për kualifikim që gjendet në DT dhe operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatitin ofertat dhe të paraqesin të plotë dokumentacionin e kërkuar në DT.

Referuar seksionit II të dokumentave të tenderit “Udhëzime për operatorët ekonomikë” “Hartimi I Ofertës”ku përcaktohet se: “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme

Po kështu sqarojmë se nëse operatori ekonomik do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, apo paqartësi ai ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës parashikuar në nenin 63 pika 1/1 e LPP apo nenin 42/1 për të kërkuar shpjegime pranë AK.

Përsa më sipër dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik VIBTIS sh.p.k do të konsiderohet i pasaktë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Vlera 11.055.000(njëmbëdhjetë milion e pesëdhjetë e pesë mijë)lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 2.8 si dhe në shtojcën për modifikim të pasqyruar në sistemin elektronik datë 05.06.2018 si më poshtë cituar:

2.8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë origjine të mallit që oferton.

2.8.Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë origjine të kompanisë prodhuese të mallit që oferton.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatorit ekonomik E-pumps sh.p.k në sistemin elektronik K.V.O konstaton se operatori nuk ka paraqitur dokumentacion për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të kërkuar në DST,çka bie në kundërshtim me kriteret e vendosura në DST.

Së dyti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

2.6.Prodhuesi i mallit duhet të jetë i çertifikuar për sistemin e menaxhimit të mjedisit certifikatë ISO 14001:2004 lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Certifikatat kërkohet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik K.V.O konstaton se për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të kërkuar në DST operatori ekonomik ka paraqitur certifikatën *ISO 14001:2004 të kompanisë prodhuese MARLI Sr.për të cilën vërehet se vlefshmëria e certifikatës së sipërcituar të prodhuesit ka qënë e vlefshme deri më datë 15.05.2017.*

Së treti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.7 si më poshtë cituar:

Të dhënat teknike të elektropompave të jenë të nxjerra nga programi kompjuterik (pump selector) ku tregohet qartazi pika e punës së çdo elektropompë dhe rendimenti i saj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin elektronik K.V.O konstaton se operatori ekonomik ka paraqitur në sistemin elektronik të dhënat teknike të kompanisë prodhuese MARLY srl për të cilën evidentohet se janë në gjuhën angleze.

Theksojmë se në shtojcën 9 të kriterëve të përgjithshme parashikohet se parashikohet se
Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Po kështu në nenin 14 të VKM nr,914 datë 29.12.2014”Për Prokurimin Publik”I ndryshuar parashikohet shprehimisht: **“Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe”. Në dokumentat e tenderit, Seksioni IV Procedura, pika IV.6 është përcaktuar shprehimisht: “Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Shqip X Anglisht Tjetër.**

Referuar seksionit II të dokumentave të tenderit “Udhëzime për operatorët ekonomik”“Hartimi I Ofertës”ku përcaktohet se: “Operatorët Ekonomikë janë të

detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.

Përsa më sipër K.V.O gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik E-Pumps-sh.p.k është i pasaktë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreut VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenet 63 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, UKT sh.a është paraqitur Formulari i Ankesës nga operatori ekonomik “**VIBTIS ” shpk**” hyrë në UKT sh.a me shkresën Nr.16686, Prot. datë 28.06.2018 (administruar në dosjen e prokurimit) në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit me objekt: ” **Blerje Elektropompa për Nevoja të Shoqërisë**”

Me marrjen e ankesës nga Operatori Ekonomik i mësipërm, në mbështetje të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 63, pika 3 si dhe në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me Urdhërin me Nr. 13323/8 Prot. dt. 18.06.2018, është pezulluar procedura e prokurimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas rregullave të parashikuara nga LPP dhe RRPP. Gjithashtu në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 6, gërma ”a” të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me Urdhërin me Nr. 13756/8 Prot. datë 28.06.2018, u ngrit Grupi i Shqyrtimit të Ankesave.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi ka shqyrtuar ankesën e operatorit ekonomik “VIBTIS”sh.p.k ka konkluduar sa më poshtë:

Nuk janë marrë parasysh pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues.

Ky konkluzion i është rekomanduar Titullarit të Autoritetit Kontraktor si dhe është vënë në dijeni Operatorit Ekonomik “**VIBTIS ”shpk**” me ane të shkresës Nr. 16686 /1 datë 02.07.2018 (administruar në dosjen e prokurimit).

Më datë 16.07.2018 , me anë të shkresës nr. 13323/10, është hequr pezullimi i procedurës pasi janë respektuar afatet e ankimit pranë KPP.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**RAMI-COMPANY**”sh.p.k , se oferta me një vlerë të përgjithshme prej 9.610.000(nëntë milion e gjashtëqind e dhjetë mijë)lekë pa tvsh pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjetës Kanalizime Tiranë sha, a me adresë rruga “5 Maji “pranë Medresesë, Tiranë me nr tel: + 355 4 2225572, Sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes /publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të vijohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 21.06.2018.

Ankesa: PO (Paraqitur nga operatori ekonomik “VIBTIS ”shpk prot hyrës 16686 datë 28.06.2018.Operatorit ekonomik i është kthyer përgjigje më datë 02.07.2018.

